V E N D I M
Nr. 294, datë 13.6.2000

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRDORIMIT TË TOKËS NË PORTIN E DURRËSIT

(Ndryshuar me VKM nr. 301, datë 14.5.2004)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8383, datë 29.7.1998, "Për ratifikimin e marrëveshjes për kredinë e zhvillimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), për projektin e Portit të Durrësit", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Miratimin e planit të përdorimit të tokës në Portin e Durrësit dhe rekomandimet e tij, me skenarin 2, për fazën I, dhe objektiv përfundimtar skenarin 3, për fazën III.

1.1 Pjesa e planit të përdorimit të tokës në portin e Durrësit, e përcaktuar për portin e peshkimit, sipas pikës 1 të vendimit nr. 294, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

1.2 Toka e kufizuar sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i kalojë në administrim nga Autoriteti Portual Durrës, sh.a., Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, për ndërtimin e portit të ri të peshkimit.

1.3 Porti aktual i peshkimit në Durrës t'i kalojë në administrim Autoritetit Portual Durrës, sh.a., pas përfundimit të ndërtimit të portit të ri të peshkimit.

2. Ngarkohet Ministria e Transportit së bashku me Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrinë e Punëve Publike, Ministrinë e Pushtetit Lokal, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Ministrinë e Drejtësisë të negociojnë për përcaktimin e afateve të zbatimit të planit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

(Shtuar me VKM nr. 301, datë 14.5.2004)